



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION




Emri i Biznesit: RTV PODGURI SH.P.K.

Numri Unik Identifikues: 811897323

Pronar: Fadil Pejani

Kandidati: RTV Podguri

Adresa: Rr/ Skenderbeu, Nr.35, Istog



VENDIM

për licencimin e Ofruesit të Shërbimeve Mediale Adiovizuale “RTV Podguri” për
transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes – me seli në Istog

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audiovizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Rregullorja për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2021/01, e ndryshuar dhe plotësuar ka hyrë në fuqi më 17 dhjetor 2021, ndërsa, me Kreun IV të kësaj rregulloreje, KPM ka krijuar bazën ligjore për licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Audio dhe Audiovizuale të cilët transmetojnë përmes operatorëve të shpërndarjes, e që do të kenë mundësi të prodhojnë programe përmbajtësore dhe t'i transmetojnë ato përmes cilit do operator të shpërndarjes.
3. Më datën 7 mars 2022, kandidati “RTV Podguri”, ka parashtruar aplikacionin për licencë të KPM-së për të vepruar si ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale (OSHMA) për transmetim përmes operatorit të shpërndarjes.


Arsyetim

4. Ligji Nr. 04/L-44 për Komision i Pavarur për Media, përcakton se KPM është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësit e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbime mediale audio-vizuale.

5. Neni 21, paragrafi 1 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon KPM-ja”*.
6. Komisioni vlerëson se, kandidati për licencë të KPM-së OSHMA “RTV Podguri”, në aplikacionin e tij ka paraqitur të dhënat e nevojshme për Licencë të KPM-së në pajtim me Ligjin e KPM-së dhe me Rregulloren KPM-2021/01.
7. Komisioni vlerëson se, kandidati për licencë të KPM-së “RTV Podguri” ka ofruar të dhënat e mjaftueshme për vlerësim të aplikacionit. Materialet e ofruara si pjesë e aplikacionit konsiderohen të qëndrueshme sa i përket skemës programore në përgjithësi; të dhënat rreth aftësive profesionale dhe menaxheriale për të udhëhequr me ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale, përfshirë edhe të dhënat rreth qëndrueshmërisë financiare.
8. Sipas Kapitullit V, Nenit 13, Paragrafit 5 të Rregullores KPM-2021/01, kandidati për licencë të KPM-së për ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale “RTV Podguri”, duhet të veprojë në pajtueshmëri me të gjitha rregullat dhe aktet tjera nënligjore të nxjerra nga KPM, në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së, si dhe me ligjet tjera të zbatueshme në Republikën e Kosovës.
9. Komisioni vlerëson se, kandidati “RTV Podguri” ka përmbushur kriteret kualifikuese për t’u pajisur me licencë të KPM-së për ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale, në pajtim të plotë me Rregulloren e KPM-së KPM-2017/02.

Vendim

10. Komisioni në takimin e tij të mbajtur më datën 5 prill 2022, merr vendim për që, kandidatit “RTV Podguri”, me seli në Istog, t’i lëshoj licencën për të vepruar si Ofrues i Shërbimeve Mediale Audiovizuale përmes operatorëve të shpërndarjes, në Republikën e Kosovës.
11. Këtë vendim e lëshon Komisioni dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.



Xhevat Latifi

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



12.04.2021

datë